

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 5”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema.**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 9 maj 2024, ora 12:10 zhvillohet seanca e shortit “Për caktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 5, me ankues partia Socialiste e Shqipërisë, me objekt ankimi: “Kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 38, datë 9.04.2024”. Ky vendim ka të bëjë me raportin e gjetjeve të auditimit të raporteve financiare për vitin kalendarik 2022. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në njërin kemi shënuar kërkesa ankimore nr. 5, katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat vendosen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm në hedhjen e shortit, kanë autorizuar një përfaqësues të administratës së KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre, duke filluar nga rendi alfabetik rritës me zotin Elvin Lako i pari, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe në fund zoti Ledio Braho. Të pesë goglat me shiritat e letrës që janë futur në enën transparente përziejhen nga përfaqësuesi i KQZ-së dhe:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvin Lako: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvis Çefa: – Kërkesa ankimore nr. 5.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.9.05.2024*

Zotit Ilirjan Rusmali: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Koli Bele: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ledio Braho: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, zoti Elvis Çefa është relator i kërkesës ankimore nr. 5.

Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

